



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1195/Prot.
3

Tiranë, më 25/11 /2016

VENDIM

Nr. 90, datë 25/11 /2016

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

VËREN:

Ankuesi/ Qendra “Res Publica”, përfaqësuar nga Av. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 1195 Prot., datë 04.11.2016, ndaj Autoritetit Publik/ Prokurorisë së Përgjithshme/ Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare”. Ankuesi në cilësinë e kërkuesit, me shkresën e datës 04.10.2016 ka kërkuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, t’i vihet në dispozicion informacioni dhe dokumentacioni i disponueshëm si më poshtë vijon:

1. Në çfarë faze është procedimi penal për kallëzimin e bërë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit me nr.prot.1103, datë 31.03.2013, për veprën penale të shpërdorimit të detyrës (neni 248 i Kodit Penal) ndaj punonjësve të Agjencisë së Kërkimit Teknik dhe Inovacionit.
2. Kopje të vendimit të marrë nga prokuroria për kallëzimin e mësipërm.
3. Kopje të kallëzimit të bërë nga KLSH me nr.prot.1103, datë 31.03.2013.
4. A i është komunikuar KLSH-së vendimi i marrë nga Prokuroria për kallëzimin e mësipërm dhe në cilën datë.

Ankuesi pretendon se është cënuar në të drejtën për informim, pasi nuk është informuar lidhur me sa ka kërkuar dhe për këtë arsye ka depozituar ankim pranë Zyrës së Komisionerit. Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri pas vlerësimit të ankesës, me urdhrin nr. 243 Prot, datë 21.11.2016, ka urdhëruar kryerjen e inspektimit administrativ pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Gjatë inspektimit u konstatua se kërkesa e Qendrës “Res Publica” është depozituar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe është regjistruar me nr.5222 Prot., datë 10.10.2016. Kjo kërkesë i është sigluar për trajtim prokurorit pranë Njesisë së Taskë Forcës.

Nga ana e grupit të inspektimit u konstatua se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës së Qendrës “Res Publica” të datës 04.10.2016.

Lidhur me ankesën e Qendrës “Res Publica”, u kontaktua me punonjësit e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga ana e grupit të inspektimit u pyetën punonjësit nëse dokumentacioni i kërkuar nga ana e Qendrës “Res Publica” është i regjistruar, pra nëse disponohet apo jo nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë si dhe arsyet pse nuk është trajtuar kërkesa për informim brenda 10 ditëve pune nga data e dorëzimit të saj në përputhje me Ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Nga ana e përfaqësuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, u sqarua se: *“Informacioni i kërkuar nga Qendra “Res Publica” është i regjistruar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Konkretisht sqaroi se për shkresën nr. 1103 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr.852 për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i KP. Ky procedim është pushuar më datë 09.09.2014. Për shkak të ngarkesës dhe lëvizjes së Drejtuesit të Task-Forcës nuk është bërë i mundur kthimi i përgjigjes në kohë”.*

Pas parashtrimeve të fakteve u përpilua procesverbali i cili u firmos pa vërejtje nga ana e punonjësve të Prokurorisë së Shkallës së Parë Tiranë.

Pas shqyrtimit të ankesës, inspektimit të ushtruar si dhe pas konsultimit të legjislacionit përkatës rezulton se, informacioni i kërkuar nga Qendra “Res Publica” është i regjistruar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe si i tillë ai administrohet prej kësaj të fundit. Ekzistenca e dokumentacionit pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga autoriteti publik, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”.*

Duke qenë se për informacionin e kërkuar në pikën 2 *“Kopje të vendimit të marrë nga prokuroria për kallëzimin e mësipërm”* rezulton një vendim pushimi mbi procedimin e nisur, atëherë ky informacion mund të bëhet publik në përputhje me nenet 287, 328 dhe 329 (kjo e fundit, dispozitë e cila parashikon drejtëpërdrejtë palët të cilat kanë interes të ligjshëm për marrjen e këtij informacioni në mënyrë të plotë) të Ligjit nr.7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; nenin 17 pika 6 e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe në respektim të neneve 5, 6 dhe 7 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar si dhe Udhëzimit nr.15, datë 23.12.2011 “Për përpunimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor” (marrë si analogji edhe për këtë rast).

Gjithashtu edhe informacioni i kërkuar në pikën 3 të objektit të kërimit *“Kopje e kallëzimit të bërë nga KLSII ...”*, mund të bëhet publik në përputhje me nenin 17, pika 6 e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe në respektim të neneve 5, 6 dhe 7 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Nën këto argumente ligjorë, nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër duhet t’i vendoset në dispozicion ankuesit Qendrës “Res Publica”. Personat përgjegjës për dhënien e informacionit të kërkuar duhet të bëjnë anonimizimin e të dhënave në përputhje me nenet e sipërcituara.

Ndërsa, lidhur me pikën 1 "Në çfarë faze është procedimi penal për kallëzimin e bërë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit me nr.prot.1103, datë 31.03.2013, për veprën penale të shpërdorimit të detyrës (neni 248 i Kodit Penal) ndaj punonjësve të Agjencisë së Kërkimit Teknik dhe Inovacionit" dhe pikën 4 "A i është komunikuar KLSH-së vendimi i marrë nga Prokuroria për kallëzimin e mësipërm dhe në cilën datë", rezulton se ky lloj informacioni nuk përmban elementë të dispozitave të lartëpërmendura dhe si i tillë ai i duhet vënë në dispozicion ankuesit.

Theksojmë, se e drejta për t'u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkcionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Qendrës "Res Publica" ndaj Autoritetit Publik/ Prokurorisë së Përgjithshme/ Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 'Për të drejtën e informimit', shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 'Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative',

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Qendrës "Res Publica", Nr. 1195 Prot., datë 04.11.2016, ndaj Autoritetit Publik/ Prokurorisë së Përgjithshme/ Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/ Prokurorisë së Përgjithshme, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar në pikën 1 dhe 4, në formën e kërkuar, brenda datës 07.12.2016.
3. Urdhërimin e Autoritetit Publik/ Prokurorisë së Përgjithshme, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, në pikën 2 dhe 3 në përputhje me nenet 287, 328 dhe 329 të Ligjit nr.7905, datë 21.3.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; nenin 17 pika 6 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" si dhe në respektim të neneve 5, 6, 7 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, brenda datës 07.12.2016.
4. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
5. Ky vendim u dha sot në datë 25.11.2016.

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI